# REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
## KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

---

Duke u bazuar në nenin 12, 17, 24 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenin 28, 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, nenit 45 paragrafi 4, nenit 46 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-048, për menaxhimin e financave publike te përgjithshme, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 27/2008", Kuvendi i Komunës në Suharekë, ne mbledhjen e mbajtur me datën 27.03.2018 miratoje këtë:

## V E N D I M
Për miratimin e llogarisë përfundimtare te të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor 2017.**

### Neni 1.
Me këtë vendim miratohet llogaria perfundimtare e Komunës se Suharekës për periudhën Janar – **Dhjetor të vitit 2017**, i cila përmban te dhënat si më poshte:

| Nr.Rd | Mjetet e Komunës | Realizimi 2017 | Përqindja |
|---|---|---|---|
| 1 | Te ardhurat e gjithëmbarshme | 14,383,806.09 | 100.00% |
| 2 | Të daluarat e gjithëmbarshme | 13,606,775.05 | 94.60% |
| 3 | **Teprica e të hyrave ndaj të daluarave** | **(777,031.04)** | -5.40% |
| a | Teprica e të hyrave ndaj të daluarave B.R.K | 81,131.41 | 0.56% |
| b | Teprica e financimeve nga huamarrjet | 961.50 | 0.01% |
| c | Teprica e të hyrave ndaj të daluarave Mjetvetanake 2017 | 535,694.15 | 3.72% |
| d | Tepric e të hyrave ndaj të daluarave Mjetvetanake 2016 | 159,243.98 | 1.11% |
| | Teprica për bartje në vitin 2017 | **694,938.13** | 100.00% |

### Neni 2.
Të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara si dhe teprica e të ardhurave në raport me shpenzimet e administruara te përcaktuara si në nenin 1 të këtij vendimi, jane shpalosur ne bilancin e mjeteve të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor** të vitit 2017 dhe raporti si i tille eshtë pjese perberese e këtij vendimi.

### Neni 3.
Realizimi dhe zbatimi i këtij vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjeve në fuqi dhe Rregulloren e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar të komunës së Suharekës.

### Neni 4.
Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset qeveria lokale e Komunës së Suharekës.

### Neni 5.
Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn ne fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim te nenit 81, te Ligjit Nr 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008", nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016 për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

K U V E N D I K O M U N Ë S – S U H A R E K Ë

01-Nr01 - 13996
Më datë 28.03.18

Kryesuesi i Kuvendit
Bexhet KUÇI